

Uebinar për faktorët shtytës të reformave të kontabilitetit në sektorin publik
10 mars 2021

RËNDËSIA E FAKTORËVE SHYTYTËS TË REFORMËS DHE NDIKIMI QË EKONOMIA POLITIKE KA NË ZBATIMIN E REFORMAVE

Dr Verena Fritz, Pikë kontakti e qeverisjes për Serbinë & Menaxhere
Programi, Reformat për Qeverisjen e Mirë dhe Klimën e Investimeve

PËRSE DUHEN PARË FAKTORËT SHTYTËS JOTEKNIKË TË HARTIMIT DHE ZBATIMIT TË REFORMËS SË MFP-SË?


Gjatë dy dekadave të fundit ka pasur një shtytje të madhe globale për reformat e MFP-së.

Rekomandimet dhe synimet teknike për reformat të parashikuara në strategjitë e reformave përbëjnë një paketë mjaft standarde, mirëpo rezultatet dhe ritmi i reformave nuk është aspak i njëjtë.

Anketat me vendet përfituese tregojnë se qeveritë dëshirojnë që Banka Botërore t'i marrë më shumë në konsideratë kushtet e vendeve.

Në përgjithësi mendohet se politika dhe palët e interesit kanë rëndësi, por kjo nuk bazohet në të dhëna.

A mund ta sistematizojmë këtë më shumë dhe t'i bëjmë njohuritë më të dobishme për reformuesit dhe mbështetësit e reformave?





Burimi: Të dhëna të OECD-së mbi ODA (QWIDS)

RAPORTI MIDIS NIVELEVE TË PBB-SË DHE ECURISË SË MFP-SË ... DHE NDRYSHIMET GJATË KOHËS

të dhënat më të hershme të PEFA-s

të dhënat më të fundit të PEFA-s (përditësim i 2020)




Përmirësimet e rezultateve në PEFA kanë qenë relativisht më të mëdha te një sërë vendesh me të ardhura të ulëta dhe me të ardhura të ulëta në të mesme, sidomos në Afrikë + **rezultate ndjeshëm më të mira në vendet e EAQ-së.**

→ stabilizimi i lakores së trendit gjatë kohës


Ndryshim ndjeshëm më pak pozitiv del nga mesataret rajonale dhe të grupeve të të ardhurave në vlerësimin CPIA-13.

PËRDORIMI I PEFA-S PËR TË VLERËSUAR REZULTATET E MFP-SË GJATË KOHËS


Gjeorgjia – 2008 dhe 2013



Filipinet – 2010 dhe 2016



Vend shembull nga EAQ




Kjo mund të jetë një mënyrë e mirë për të pasur një panoramë “të çastit” se si kanë ecur vendet gjatë kohës dhe nëse progresi është i balancuar mes aspekteve të ndryshme të MFP-së.

Kontabiliteti dhe raportimi ka pasur ulje-ngritje dhe jo një progres të qëndrueshëm të reformës.

Atëherë, si shpjegohen këto tendenca sa u takon rezultateve dhe aftësive të MFP-së?

- “Pamja globale” – qëllimet e politikave dhe shtysat politike për fuqizimin e qeverisjes dhe të MFP-së.
- Institucionet, dispozitat ligjore dhe kërkesa qytetare për reforma.
- Reformat e veçanta në të gjithë ciklin e buxhetit/fushat e MFP-së dhe mënyra si marrin trajtë nga dinamikat dhe problematikat e veçanta.



FAKTORËT SHTYTËS KRYESORË TË ANGAZHIMIT GLOBAL POLITIK PËR REFORMAT E MFP-SË

- Angazhimi politik – i diskutuar shpesh, por rrallë i shikuar në mënyrë sistematike.
 - Mbahen parasysh tri lloje faktorësh:
 - premtimet zgjedhore, fuqia e mandatit dhe të pasurit e një plani se si të zhvillohen reformat;
 - qëllimet madhore të politikës;
 - nevoja për të reaguar sipas tendencave fiskale.
- Faktorët ligjorë dhe institucionalë
 - Si pjesë e “pikënisjes” por edhe si objektivi për reformat – si ndikohet te lehtësia/vështirësia e çuarjes përpara të reformave dhe si arrihen përmirësimet funksionale;
 - Aspektet ligjore: Legjislacioni organik për MFP-në, auditimi i jashtëm dhe prokurimet;
 - Institucionale: (i) organizimi i CFA-ve dhe (ii) marrëdhënia ekzekutiv-legjislativ lidhur me (a) miratimin e ligjeve të buxheteve vjetore, (b) shqyrtimin e raporteve të auditimit dhe (c) miratimin e legjislacionit përkatës për reformat;
- Ana e kërkesës luan rol të kufizuar
 - Për shumicën e qytetarëve këto reforma nuk njihen mirë, terminologjia dhe konceptet e përdorura nuk kuptohet lehtë, pak punohet për ta përkthyer atë çka bëhet dhe përse bëhet në gjuhën e përditshme.

NGJASHMËRIA / NJËTRAJTSHMËRIA E SYNIMEVE TË DEKLARUARA TË REFORMËS

	Gjeorgjia	Nepali	Nigeria	Filipinet	Tanzania
Kuadri Buxhetor Afatmesëm	√	√ (ndaluar)	√	√	Filluar në fund të viteve '90, ende në proces
Buxhetimi me bazë programi	√	x	x	√	√
Përdorimi i llogarisë unike të thesarit	√	√	√	√	√
FMIS	√	√	√	√	Futur për herë të parë fund të viteve '90
Futja në zbatim e SNKSP-ve	√	√ (me bazë monetare)	√	√	√
Përdorimi i prokurimit elektronik	√	√	x	Prokurimi elektronik është futur në zbatim gjatë fazës së hershme të reformës; ende në proces	Pjesërisht në përdorim në fillim të periudhës
Futja/fuqizimi i auditimit të brendshëm	√	√	√	√	√
Fuqizimi i auditimit të jashtëm	√	√	x	√	√

Nuk ka thujtse asnjë vend ku nuk po planifikohet një reformë

POR “PENGESAT SHTRËNGUESE” NDRYSHOJNË NGA VENDI NË VEND

Ndryshime në afatet e miratimit të buxhetit

Administrimi i likuiditetit përbën problem madhor në disa vende/periudha kohore

Koherenca institucionale midis planifikimit, përgatitjes së buxhetit dhe zbatimit të buxhetit

Shkalla dhe cilësia e transparencës së financave publike

Rëndësi ka se njëtrajtshmëria në synimet e reformave më shumë duket si zgjedhje se sa si “imitim izomorfik” i imponuar

- Normat, standardet dhe rrjetet ndërkombëtare luajnë një rol të rëndësishëm, siç përshkruhet për reformat e veçanta më poshtë

TË SHPESHTA JANË REFORMAT E PJESSHME E TË PAPLOTA

... por jo gjithmonë njihen qartë si të tilla

Reformat e pjeshme të MFP-së që hasen më shpesh:

- MFP-të më parë përcaktonin ca objektiva të përgjithshme, por jo për të caktuar me vendosmëri shpërndarjet shumëvjeçare
- Shumë llogari unike thesari gjysmake – disa llogari janë unifikuar, të tjera jo
- Sisteme informatike nga të cilët vetëm disa module përdoren ose që nuk zbatohen sipas planit në çdo ministri linje dhe njësi të qeverisjes nën nivelin qendror, ose të cilat integrohen vetëm për disa aspekte, në mos për asnjë
- Buxhete programore si shtesa ndaj buxheteve me zëra

Reformat e pjeshme në vetvete nuk janë problematike nëse ndodhen në fazë të ndërmjetme, por . . .

- . . . duhet njohur qartë si të tilla
- . . . mund të jenë shenjë e ngecjes në progres
- . . . problematike nëse çojnë në përplasje midis asaj që parashikohet në akte nënligjore dhe asaj që ndodh në praktikë (p.sh., anashkalime duke vijuar me punën manuale) – kjo mund të jetë problem për reformat e kontabilitetit

PËRVOJA ME NDËRRIMIN E STANDARDEVE TË KONTABILITETIT

- Të pesta vendet e studiuara duan të bëjnë kalimin drejt SNKSP-ve
 - Në disa raste afatet për të kaluar në SNKSP janë ndryshuar
- Deri tani, trendi që shihet është drejt vlerësimeve përmirësuese të “standardeve të përdorura”, me disa vonesa në vlerësimet e “cilësisë së informacionit” të raporteve të ndërmjetme të buxhetit
 - Vlerësimet PEFA mbështeten në atë që raportohet në raportet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe nuk orvaten të bëjnë një vlerësim të drejtpërdrejtë të cilësisë së zbatimit të standardeve të kontabilitetit
 - Pak a shumë e ngjashme me reformat e prokurimit – d.m.th., vëmendja përqendrohet nëse ka apo jo rregulla, por ende nuk kuptohet mirë se si përdoren këto rregulla dhe se çfarë ndikimi kanë
- Disa sfida të rëndësishme në diskutimin dhe përvojat deri tani:
 - Kostoja e kalimit drejt SNKSP-ve – p.sh., përmendet se është shumë e lartë, por e vështirë të vlerësohet
 - Besueshmëria e përdorimit të standardeve – duhet kontrolluar nga funksionet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, por edhe vetë këto funksione mund ta kenë të vështirë të identifikojnë problemet/çështjet/kufizimet, sidomos gjatë periudhës së tranzicionit
 - Rrjedhojat për transparencën fiskale dhe “lexueshmërinë” nga palë të ndryshme interesi

RRJEDHOJA & REKOMANDIME

Përse/motivimi për reformat

Duhet qenë më të qartë për qëllimin e reformave të kontabilitetit dhe se si lidhen me sfidat kryesore të tanishme dhe të ardhshme të buxhetit dhe të MFP-së

- P.sh., probleme me administrimin e likuiditetit dhe me detyrimet e prapambetura? Apo aspak problem?
- Pasha e kostove të ardhshme për pensionet dhe kujdesin shëndetësor? Rreziqet fiskale nga NSH-të?
- Shmangia nga teprimi i përfitimeve të pritura – reformat e kontabilitetit nuk e eliminojnë korrupsionin dhe keqadministrimin – ato duhen shoqëruar me faktorë të tjerë

Qytetarët mund të mos kenë shumë interes – por ia vlen dialogu kuptimplotë

Një mundësi e konsiderueshme për të shpjeguar më mirë reformat e MFP-së dhe të kontabilitetit në formë të thjeshtë – duke evituar pretendimet e tepruara për rezultatet e mundshme

Një mundësi e re dhe kërkesë e re që kontabiliteti të mbulojë më mirë aspektet e klimës dhe të mjedisit

RRJEDHOJA & REKOMANDIME

Si dhe kush

Duhet qenë të qartë për organizimin dhe rolet institucionale – për të vlerësuar vështirësitë e mundshme, si edhe për të identifikuar rrugën e tranzicionit

- Si do të përfshihen nivelet e qeverisjes në nivelin qendror? Çfarë thonë ministrinë sektoriale?
- Si i përdorin palët e ndryshme të interesit informacionet ekzistuese kontabël?
- Të bëhet dialog me palët e interesit – të mos merret si e mirëqenë ndarja midis “mbështetësve të reformës” dhe “kundërshtarëve të reformës”

A duhet hartuesit e reformave të synojnë enkas reforma të pjesshme? Përdorimi i SNKSP-ve me bazë monetare ofron një bazë për këtë

Të mendohen plotësuesit e reformave

- Përmirësimi në mënyrë kuptimplotë i transparencës fiskale


Të mendohen rreziqet e pasojave të pasynuara negative dhe si të mbrohemi sa më mirë prej këtyre

- Kostot e tranzicionit
- Mundësitë për fshehjen e pozicionit të vërtetë fiskal – shumë qeveri do të tundohen, në një moment, t’i manipulojnë shifrat

RRJEDHOJA & REKOMANDIME

Vëmendja te pengesat ndaj qëndrueshmërisë dhe ndikimit – reformat e MFP-së, përfshirë reformat e sistemit kontabël, ndonjëherë mund të mbeten në nivel formal e të mos shfrytëzohen plotësisht

- Monitorimi: shikohen rezultatet e vlerësimeve të përsëritura PEFA, por shkohet edhe më tej – p.sh., verifikohet vërtetësia e kontabilitetit pas futjes së standardeve të reja (p.sh., ROSC/raportet për transparencën fiskale)
- Përmirësime në vazhdimësi: A po përdoren vërtet standardet e reja të kontabilitetit më shumë për të nxitur debate dhe bërje politikash të informuara? A ka boshllëqe që duhet të marrin zgjidhje?



Faleminderit!

Links:

<https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/28887>

<https://blogs.worldbank.org/governance/what-recent-trends-suggest-pfm-performance-covid-19-impacted-world>